

## H Y R J E

Ne mbeshtetje te nenit 2, paragrafi i pare, shkronja "b" e Ligjit Nr.7512, date 10.08.1991, "Per saksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe te privatizimit", dhe te ligjit Nr.7632, date 04.11.1993, qe rregullon pjesen e pare te kodit tregtar, personat fizike:

Dante Arnoldi, i biri I \_\_\_\_\_, i dt. 01.01.1970, lindur dhe banues ne Torino me adresë Rr. "Lancia" Nr. 66/10100 me pasaporte Nr. \_\_\_\_\_, me shtetesi dhe kombesi italiane, hartozi kete statut te shoqerise tregtare "COFFEE CLUB" shpk

### K O N T R A T E PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE "COFFEE CLUB" shpk

#### I. DISPOZITA TE PERGJITHESHME

##### N E N I 1

Ortaku themelues krijon shoqerine private me mjetet e tij, fillimisht me një kapital themelor prej 1.000.000.leke, qe derdhet nga ortaku pa detyrim interes i prane noterit qe kryen veprimet notoriale ne kuadrin e legalizimit te shoqerise.te shoqerise .

##### N E N I 2

Shoqeria nga nen i i kesaj kontrate do te ushtroje veprimtarine e saj te percaktuar ne kete kontrate, me emertimin "COFFEE CLUB" shpk

##### N E N I 3

Shoqeria ka cilesine e personit juridik me perqejjesi te kufizuar shpk

##### N E N I 4

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr. "Barikadave" Nr. 4/2.

##### N E N I 5

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilin eshte shkruar teksti: "Shoqeria tregtare "COFFEE CLUB-TIRANE". Fjala TIRANE eshte shkruar ne mesin e trethit.

#### II. OBJEKTI I VEPRIMTARISE

##### N E N I 6

Shoqeria private "COFFEE CLUB" shpk ka per objekt te veprimtarise se saj:

- Investime ne sektore te ndryshem, ne ndertime e studime urbanistike, si ne industri e prodhimit te konfeksiioneve. Prodhime druri per paisje e orendi shtepiake ne fushen e sherbimeve. te prodhimeve ushqimore, per llogari te vet apo per llogari te te treteve.
- Do te ushtroje aktivitet tregtar privat, ne formen e import-eksportit, per artikuj te ndryshem industriale, ushqimore, prodhime bujqesore e blegtorale, duhane, pije alkolike shperndarje kafeje, etj te shoqeruara me paisje e makineri perkatese si dhe paisje e aparatura elektrike e elektronike, lende te para per industrine ushqimore, shitje pjese kembimi auto, makineri te ndryshme, etj.

Ne kete kuptim shoqeria ka te drejte te kryeje veprimitari tregtare te natyres se import-eksportit sipas nevojave te tregut shqiptar dhe anasjelltas, te kryeje veprimitari komisionere, aktivitet koncisionar me apo pa depozitime te burimeve finaciare.

- Te zhvilloje veprimitari ne industrine e perpunimit e ne ate te gjuetise se peshkut, te zhvilloje veprimitari turistike, brenda dhe jashte territorit te Shqiperise, zhvillimin e qendrave te informacionit per investitoret e huaj dhe per llogari te afariszteve shqiptare, seminare, panaire, etj.

- Shoqeria gjithashtu mund te kryeje veprimitari tregtare dhe ne fushen e pasurive te patundeshme, n. per llogari te te treteve, realizimin e kontratave Leasing, etj, si dhe cdo lloj veprimitarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fiotime dhe te ardhura te ligjeshme.

#### N E N I 7

Shoqeria private "COFFEE CLUB" shpk ushtron veprimitarine e saj te percaktuar ne nenin 6 te kesaj kontrate ne territorin e shoqerise dhe jashte saj per te realizuar veprimitarine e parashikuar.

Per realizimin e kesaj veprimitarie shoqeria mund te hapi dyqane per aktivitet te mirefillte tregtar, zyra perfaqesimi apo dhe filialat e saj, brenda dhe jashte territorit te Shqiperise.

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline dhe veprimitarine e saj vetem me pelqimin e ortakeve.

#### N E N I 8

Shoqeria private "COFFEE CLUB" shpk i ka te gjitha autorizimet per te vepruar me persona te trete private ose shteterore, vendas dhe te huaj. Per detyrimet e veta, te krijuara ne veprimitarine e saj me persona te trete, shoqeria per gjigjet ne baze te pasurise se vene, qe formon kapitalin shoqeror te themelimit.

#### I. MJETET E NDERMARRJES

##### N E N I 9

Mjetet ne te holla dhe mjetet e tjera ne momentin e themelimit te shoqerise dhe fillimin e punes se shoqerise, ortaku themelues e siguron ne shumen 1.000.000 leke.

I gjithe kapitali themeltar ndahet ne 100 kuota, teresisht te disponuara prej ortakut themelues.

Kuotat qe vertetojne kontributin fillestar te ortakut themelues jane te depozitueshme dhe te kunderfirmosura ne prani te nje noteri dhe persa kohe shoqeria eshte ne krijim e siper mbahen te blokuara tek noteri qe verteton nenshkrimet e artakut themelues te e ketij akti themelii te shoqerise.

Shoqeria private "COFFEE CLUB" sh.p.k. do te kete ne njerun nga bankat qe ndodhen ne territorin e Shqiperise nje numer llogarie bankare per kryerjen e operacioneve te nevojeshme.

##### N E N I 10

Ortaku I vetem themelues mban te drojten e pronesise ne kuotat e percaktuara ne nenin 9 te kesaj kontrate, te investuara per krijimin e kesaj shoqerie. Pranohet qe kuotat, ne raste shite apo kalimi ne trashegimi, te jene te pandashme. Ne raste te tilla veprohet nepermjet nje perfaquesuesi.

Shoqeria do te kete numur llogarie ne Banken e Shtetit Tirane dhe ne cdo banke tjeter private te njohur me ligj.

## N E N I 11

Shoqeria private "COFFEE CLUB" shpk do te filloje aktivitetin e saj pasi te behet regjistrimi i saj ne Gjykate dhe te marre miratimin e organeve kompetente, ne baze te legjisacionit shqiptar.

## N E N I 12

Zgjerimi i aktivitetit te shoqerise ose prishja e saj do te behet ne perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare" dhe persa parashikohet ne statutin e shoqerise, i cili hartohet ne vijim e ne pajtueshmeri me kete kontrate themeluese.

## IV. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### N E N I 13

Shoqeria "COFFEE CLUB" shpk zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me kete kontrate, statutin e saj dhe me legjisacionmin shqiptar.

Ortaku themelues e drejton veprimtarine e shoqerise duke u mbeshtetur ne te drejten e tij te pronesise private ne mjetet e investuara ne kete shoqeri.

### N E N I 14

Menyra e drejtimit dhe perfaqesimit te shoqerise "COFFEE CLUB" shpk do te kryhet ne baze te statutit te saj.

Ne rastese numri I ortakeve te shoqerise ritet ne me shume se nje Secili nga ortaket ka te drejte te largohet nga shoqeria me deshiren e tij, por me kusht qe te njoftoj me pare ortakun tjeter me shkrim, te pakten I muaj me pare. Ne kete rast ka te drejte te marre pjesen e tij te fitimit, sipas kapitalit te futur fillimi, pasi te jete pervesuar likuidimi prej tij i detyrimeve eventuale nga banka.

## V. ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

### N E N I 15

Organet drejtuese te shoqerise "COFFEE CLUB" shpk jane:

- Asambleja e shoqerise, qe perbehet nga ortaku themelues persa kohe qe eshte I tillle.
- Administratori I shoqerise dhe administrata e saj qe zgjidhet nga ortaku themelues dhe administrata e shoqerise .

### N E N I 16

Administratori i shoqerise caktohet nga ortaku I vetem, po ashtu dhe zevendesi i tij.

Drejtori i shoqerise emerohet po nga asambleja e ortakeve, me propozim te administratorit te shoqerise.

Ortaku I vetem vendos qe administrator i shoqerise per nje periudhe kohore te pa caktuar te emerohet Ndrek Zaja I biri I Gjetes I dt 17.02.1964 banues ne Tirane Rr "5 Maji" Nr 64 .

### N E N I 17

Asambleja (ortaku I vetem persa kohe eshte I tillle) eshte organi me i larte i shoqerise dhe cdo vendim i saj eshte kolegjal.

*(Stamp: ANTONIO DURAKO NOTAR)*  
Administratori dhe drejtori i shoqerise perfaqesijne shoqerine, brenda autorizimeve qe parashikon akti I themelimit dhe Brenda delegimeve te tjera qe jane te vlefshme nese jane ne menyre te shkruar e konform akteve te perfaqsimit.

#### NENI 18

Administratori i shoqerise ka te drejte te merret me te gjitha veprimtarine e shoqerise, te marre ne pune persona te ndryshem me kontrate te rregullt, te cilet i nevojiten shoqerise; te lidhe kontrata furnizimi e shperdarje vetem brenda teritorit te shtetit Shqiptar por gjithnjë, duhet marre pelqimi paraprak te ortakut te vetem themelues. ..

Pranohet nga ortaku I vetem I shoqerise ka si organ ekzekutiv te tijin drejtorin e pergjithshem te shoqerise dhe si i tillë administratori mund ti deleojo atij ato kompetenca qe shikohen te aresyeshme prej tij dhe qe i gezon mbi bazen e akteve themeluese te shoqerise.

#### VI. FITIMI I SHOQERISE

#### NENI 19

Shoqeria "COFFEE CLUB" shpk krijon fitimin e saj me ushtrimin e veprimtarise se saje te percaktuar ne kete kontrate dhe ne statutin e saj. Fitimi percaktohet nga bilanci 4 mujor i shoqerise.

#### NENI 21

Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve dhe shpenzimeve te tjera nga fitimi i shoqerise dhe ndarja e mjeteve per pagat e punetoreve shoqerise i mbetet ne dispozicion fitimi neto

#### NENI 22

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ato probleme qe nuk rregullohen me kontrate pune do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Mosmarreveshjet midis punonjesve dhe shoqerise zgjidhen nga zzgjykata shqiptare. Kur pala ankuese eshte person i huaj mosmarreveshja zgjidhet nga organi qe eshte percaktuar ne kontraten perkatese.

Punonjesit nuk marrin pjesen e fitimit, te cilin e realizon shoqeria gjate aktivitetit te saj pervec rasteve kur eshte percaktuar ndryshe ne kontrate. Per punen e tyre ne shoqeri punonjesit marrin pagen e tyre, e cila pavaresisht nga rezultatet e arritura ne pune, percaktohen ne kontraten perkatese.

#### VII. KOHEZGJATJA E SHOQERISE

#### NENI 23

A fati i veprimtarise se shoqerise "COFFEE CLUB" shpk eshte parashikuar mbi 10 vjet.

Shoqeria merr fund:

- Ne ato raste te parashikuara nga legjislacioni shqiptar, si dhe kur ortaket themelues vendosin qe ti terheqin mjetet e investuara ne shoqeri.
- Kur shoqeria falimenton dhe hapet procedura e likuidimit.

#### NENI 24

Shoqeria fitin zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Gjykatën e rrethit Tirane dhe pas pajisjes me licence nga zyrat e taksa tatimeve te rajonit Nr.1 ne Tirane.

N E N I 26

Ky akt themelimi lidhet ne 5 kopje ne gjuhen shqipe e italiane dhe kur ka mosmarreveshje ne interpretimin e saj, interpretimi do te behet sipas tekstit ne gjuhen italiane. Dhe I shtrin efektet e tija juridike me fillimin e aktivitetit te shoqerise konform legjislacionit perkates.

ORTAKU THEMELUES  
DANTE ARNOLDI

DANTE ARNOLDI

*Dante Arnoldi*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE DURRES

Noter Ali Turku

Nr.....Rep 143

Nr.....Kol 43

V E R T E T I M

Sot me date 31.01.2003 u paraqit para meje Noter Ali Turku **Dante Arnoldi**, te cilit pasi iu verifikua identiteti dhe zotesia e plete juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi I tij dhe firmosi para meje Noterit aktin e themelimit te shoqerise "COFFEE CLUB" shpk redaktuar jashtë kesaj zyre pasi iu perkthye prej perkthyeses Lejla Caka, gjë qe e vertetoj rregullisht.

NOTER  
Ali Turku



Ne mbeshtetje te nenit 2. parografi i pare, shkronja "b" e Ligjit Nr.7512, date 10.08.1991, "Per saksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe te privatizimit", te Dekretit Nr.7604, date 31.07.1990, "Per veprimtarine e konomike te ndermarrjeve me pjesemarrjen e kapitalit te huaj ne Republiken e Shqiperise" dhe te dispozinave perkatese te kontrates per krijimin e shoqerise tregtare "COFFEE CLUB" sh.p.k.

Personi I poshteshenuar;

- Arnoldi Dante I biri I ~~Dante~~ I dt. 01.01.1970, lindur dhe banues ne Torino me adresë Rr.Lancia nr 66 /10100 me pasaporte nr ~~A.E.6072.6.32~~ me shtetesi dhe kombesi Italiane, hartoj kete statut te shoqerise tregtare "COFFEE CLUB" sh.p.k.

## S T A T U T

### I

### SHOQERISE TREGTARE "COFFEE CLUB" sh.p.k.

#### DISPOZITA TE PERGJITHESHME

##### N E N I 1

Shoqeria private "COFFEE CLUB" sh.p.k. nepermjet ketij statuti dhe, ne perputhje me kontraten per krijimin e saj dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te ortakut te vitem persa kohe eshte I tille dhe te punonjesve te shoqerise, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise dhe ceshtjet e tjera me rendesi per punen e kesaj shoqerie.

##### N E N I 2

Shoqeria eshte krijuar mbi bazen e ketij statusi te shoqerise dhe me parashikimet qe precizohen ne kontraten per themelimin e shoqerise private ne pajtueshmeri me ligjin dhe e bazuar me kontributin nominativ te ortakut themelues.

##### N E N I 3

Shoqeria "COFFEE CLUB" shpk, eshte person juridik shqiptar dhe si e tille vepron ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Selia legale e shoqerise "COFFEE CLUB" shpk eshte ne Tirane, Rr. "BARIKADAVE" Nr. ~~3.1.2~~

##### N E N I 4

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar teksti: "Shoqeria tregtare "COFFEE CLUB-TIRANE". Fjala TIRANE eshte shkruar ne mesin e rrithit.

Shoqeria ka intestimin e saj. Intestimi ka formen e katerkendeshit kenddrejte, me madhesi te zakoneshme, ne skajin e siperm te te cilit eshte shkruar teksti:

"SHOQERIA TREGTARE "COFFEE CLUB" shpk TIRANE"

##### N E N I 5

Shoqeria fiton te drejtat e personit juridik mbas leshimit te autorizimit nga organi kompetent shqiptar dhe regjistrimit ne organet gjyqsore dhe te finances shqiptare.

##### N E N I 6

Shoqeria "COFFEE CLUB" zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me aktet themeluese te shoqerise dhe konforme kerkesave te legjislacionit shqiptar.

Mosmarreveshjet midis shoqerise nga njera ane dhe personave te tjere fizike e juridike shqiptare apo dhe te huaj do te zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar.

Kompetencen per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te parashikuara ne paragrafin e mesiperm jane Gjykata e Shtetit Shqiptar.

#### 1. OBJEKTI I VEPRIMTARISE

## N E N I 7

Shoqeria private "COFFEE CLUB" shpk ka per objekt te veprimtarise se saj:  
veprimtarise se saj:

- Investime ne sektore te ndryshem, ne ndertime e studime urbanistike, si ne industri e prodhimit te konfeksiuneve. Prodhime druri per paisje e orendi shtepiake ne fushen e sherbimeve, te prodhimeve ushqimore, per llogari te vet apo per llogari te te treteve.

- Do te ushtroje aktivitet tregtar privat, ne formen e import-eksportit, per artikuj te ndryshem industriale, ushqimore, prodhime bujqesore e blegtorale, duhane, pije alkolike shperndarje kafeje, etj te shoqueruara me paisje e makineri perkatese si dhe paisje e aparatura elektrike e elektronike, lende te para per industrine ushqimore, shitje pjese kembimi auto, makineri te ndryshme, etj.

Ne kete kuptim shoqeria ka te drejte te kryeje veprimitari tregtare te natyres se import-eksportit sipas nevojave te tregut shqiptar dhe anasjelltas, te kryeje veprimitari komisionere, aktivitet koncisionar me apo pa depozitime te burimeve finaciare.

- Te zhvilloje veprimitari ne industrine e perpunimit e ne ate te gjetet se peshkut, te zhvilloje veprimitari turistike, brenda dhe jashte territorit te Shqiperise, zhvillimin e qendrave te infosrmacionit per investitorët e huaj dhe per llogari te afarishteve shqiptare, seminare, panaire, etj.

- Shoqeria gjithashtu mund te kryeje veprimitari tregtare dhe ne fushen e pasurive te patundeshme, per llogari te te treteve, realizimin e kontratave Leasing, etj, si dhe cdo lloj veprimitarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fiotime dhe te ardhura te ligjeshme.

## N E N I 8

Per realizimin e kesaj veprimitarie, pavec qendres ne qytetin e Tiranes, shoqeria "COFFEE CLUB" sh.pk. mund te hape dege dhe zyra, filiale perkatese te saja, jashte selise, duke u mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar. Shoqeria mund te ndryshoje objektin e veprimitarise se saj, emertimin dhe seline e saj, vetem me pelqimin e ortakut te saj themelues.

## N E N I 9

Shoqeria "COFFEE CLUB" shpk ushtron veprimitarine e saj per te realizuar fitimin, duke u mbeshtetur ne parime te likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit, si dhe vetem mbi bazen e legjislacionit shqiptar.

Shoqeria ka te gjitha autorizimet ne qarkullimin juridik me persona te trete.

## III. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT THEMELUES

### N E N I 10

Ortaku themelues ka keto te drejta kryesore:

- Merr vendime me atributet e e asamblese se ortakeve.

- Direkt apo nepermjet personave te deleguar merr pjese ne administrimin e veprimitarise se shoqerise, ne perputhje me percaktimet qe jane parashikuar ne kontraten e themelimit dhe me permbytjen e ketij statuti.

- Perfiton te gjitha fitimin e shoqerise konforme legjislacionit shqiptar, nga rezultatet ekonomike-finaciare te shoqerise ne te gjitha format dhe trajtat e ketyre rezultateve, si ne sasi dhe ne vlete, ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kontraten e themelimit. Te percaktojne kompetencat e organeve administrative dhe ekzekutive te shoqerise.

- Te informohet ne cdo kohe per te dhenat ne lidhje me rezultatet e veprimitarise ekonomike-financiare te shoqerise dhe te njihen me dokumentacionin e pote ne te cilin gjen pasqyrim veprimitaria ekonomike-financiare dhe rezultatet e kesaj veprimitarie. ka te drejte te marre ne dorezim bilancin vjetor te aktivitetit ekonomiko-fiancier, me qellim qe duke e njojur atje te kontrolloje, permiresoje dhe zhvilloje me tej kete veprimitari

- Ka te drejten e firmes per llogarine bankare te shoqerise si dhe te drejten per te deleguar kete kopetence cdo person i autorizuar prej tij .Ky autorizim duhet te jete me shkrim, firmen dhe vulen e shoqerise.

Ortaku themelues ka keto detyrime kryesore:

- Te respektojne kontraten e themelimit te shoqerise "COFFEE CLUB" shpk dhe statutin e saj.

- Te depozitojne pjesen e kapitalit, sipas nenit 9 te kontrates themeluese te shoqerise.  
Kjo te behet menjehere pas regjistrimit.

- Te mbaje mardhenie korakte me organet perkatese te shtetit Shqiptar dhe  
pergjigjet per gjithe veprimtarine ekonomike e financiare te shoqerise .

## II. MJETET E SHOQERISE N E N I 11

Mjetet ne te holla dhe mjetet e tjera ne momentin e themelimit te shoqerise dhe  
fillimin e punes se shoqerise, ortaku themelues e siguron ne shumen 1.000.000 leke.

I gjithe kapitali themeltar ndahet ne 100 kuota dhe teresist te disponuara prej ortakut  
themelues

Kuotat qe vertetojne kontributin fillestar te ortakut themelues jane te depozitueshme dhe  
te kunderfirmosura ne prani te nje noteri dhe persa kohe shoqeria eshte ne krijim e siper  
mbahen te bllokuara tek noteri qe verteton nenshkrimet e artakut themelues te e ketij statusi.

Shoqeria private "COFFEE CLUB" sh.p.k. do te kete ne njerun nga bankat qe ndodhen  
ne territorin e Shqiperise nje numer llogarie bankare per kryerjen e operacioneve te nevojeshme.

## V. ADMINISTRIMI I SHOQERISE N E N I 12

Ortaku themelues e drejton-veprimtarine e shoqerise duke u mbeshtetur ne te drejten e tij  
te pronesise private ne mjetet e investuara ne Shqiperi.

### N E N I 13

Ne rastese se numri i ortakeve te shoqerise shtohet ne me shume se nje Seicili nga  
ortaket ka te drejte te largohet me deshiren e tij por me kusht qe te njoftoje ortaket e tjere 1 muaj  
me pare. Ne kete rast ka te drejte te marre pjesen e tij te fitimit, sipas kapitalit te vene fillimisht,  
por pasi te jete vertetuar likuidimi nga ana e tij e te gjithe detyrimeve qe ka ndaj pales tjeter dhe  
shoqerise, deri ne momentin e paraqites se kerkeses per largim. Likuidimi i detyrimeve duhet te  
behet nepermjet bankes ose marreveshjes se perbashket midis paleve.

Shoqeria nuk pergiqjen me pasurite e tyre vetiake per detyrfimet e shoqerise

### N E N I 14

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e investuara ne fonde e saj dhe me mjetet e  
tjera. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi me shumen e mjetave  
te investuara ne fordin themeltar te shoqerise dhe nga shuma e mjetave te rezerves.

Shoqeria percakton fonde e meposhteme:

1. Fondin themeltar

2. Fondin reserve apo rezerva statutore

Per ushtrimin e veprimtarise se vet, shoqeria mund te percaktoje dhe fonde te tjera.

### N E N I 15

Fondi rezerve i shoqerise formohet nga nje pjesa e fitimit qe shoqeria e realizon gjate  
veprimtarise se saj. Ajo percaktohet me nje vendim te vecante te asamblese se shoqerise. Fondi  
rezerve mund te perdoret edhe per destinacione te tjera, qe jane ne perputhje me interesat e  
shoqerise.

Pas miratimit te bilancit dhe raportit finaciar vjetor nga asambleja e shoqerise, pjesa e  
fitimit neto mund te ndahet vetem me vendim te asamblese, ne masa te tilla, qe i sherbejne  
permiresimit dhe zhvillimit te aktivitetit te shoqerise, por pasi te kete hequr shpenzimet  
perkatese, qe futen ne fitimin e cdo ortaku.

## VI. ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE N E N I 16

Organet drejtuese te shoqerise private "COFFEE CLUB" sh.p.k. jane.

- Asambleja e shoqerise. qe perbehet nga ortaku themelues persa kohe qe eshte i tillë
- Administratori i shoqerise dhe administrata e saj qe qe zgjidhet nga artaku themelues..

### N E N I 17

Asambleja e ortakeve(ortaku e vetem) eshte organi me i larte i shoqerise. Asambleja e  
ortakeve zgjedh ose cakton administratorin dhe drejtorin e pergjithshem dh. ne mungese te tij.  
emeror provizorisht zevendesit e tyre.

## N E N I 18

Vendimet e asamblese se ortakeve(ortakut te vetem) marrin fuqi ekzekutive vetem pasi te jene miratuar ne menyren e duhur . -Si rregull Asambleja mblidhet jo me pak se nje here ne vjet dhe te pakten nje here ne kater muaj ben bilancin e veprimtarise se shoqerise me vendime te marra nepermjet konsultimeve apo sipas mundesive te tjera te parashikuara ne kete statut e qe vjen ne pajtueshmeri ne ligjin.

## N E N I 19

Asambleja e ortakeve (Ortaku I vetem) e shoqerise ka keto kompetenca:

- Si organi me i larte i shoqerise organizon, drejton dhe kontrollon te gjithe veprimtarine ekonomiko-financiare te saj.

- Mxjerr planin dhe programin e zhvillimit te aktivitetit te shoqerise dhe akte te per gjitheshme qe i sherbejne ketij programi. nxjerr vendimin per ndryshimin e emertimit, selise dhe objektit te veprimtarise se shoqerise.

- Vendos per irritjen ose pakesimin e fondit themeltar te shoqerise si dhe percakton fondin rezeve.

- Jep udhezime dhe porosi te nevojeshme si dhe orienton punen e administratorit te shoqerise.

- Miraton bilancin dhe raportin finanziar te shoqerise.

- Vendos per ndarjen dhe per dorimin e fitimit si dhe per mbulimin e humbjeve dhe te rreziqeve eventuale.

- Vendos per ndryshimin e formes se shoqerise (organizimin e saj).

- Vendos per mbylljen e aktivitetit te shoqerise si dhe per kohezgjatjen e saj tej afatit te percaktuar ne kontraten themeluese.

- Emeron administratorin dhe drejtorin e shoqerise.

- Drejton dhe pune te tjera te rendesishme, qe i sherbejne afarizmit te shoqerise.

- Vendos per ndryshimet eventuale ne statut.

## N E N I 20

Administratori i shoqerise per gjigjet per punen e tij para asamblese se shoqerise. Ai emerohet ose shkarkohet ne cdo kohe me vendim te arsyetur te organit qe e ka ne emertese.

## N E N I 21

Administratori i shoqerise mund te zevendesojet perkohesisht nga nje person tjeter dhe si rregull percaktohet drejtori i shoqerise dhe gezon ato kompetenca qe i delegon administratori ne menyre te shkruar.

## N E N I 22

Administratori i shoqerise drejton gjithe veprimtarine e shoqerise ne pikpamjen tekniko-administrative dhe ai ka keto kompetenca:

- Organizon dhe drejton veprimtarine e shoqerise dhe afarizmin e saj, ne baze te udhezimeve, porosive dhe orientimeve te marra nga asambleja e ortakeve.

- Perfaqeson shoqerine tek personanat e trete.

- Pergjigjet para asamblese per ligjishmerine e punes se shoqerise si dhe per aktivitetin ekonomik e financiar te saj.

- Propozon ndryshime ne organizimin e punes se shoqerise, emeron dhe shkarkon punonjesit qe ka ne vartesi.

- Mund te pezulloje ne cdo kohe punonjesit e administrates .

- Ka te drejte te lidhe kontrata, te kryeje pune e veprime te tjera juridike, brenda autorizimeve te dhena nga asambleja dhe pasi te kete marre pelqimin e saj.

- Percakton sipas nje miratimi paraprak te ortakut themelues te strukturen organizative te shoqerise, kompetencat e drejtorit te shoqerise dhe te drejtuesve te tjere te sektoreve te vecante.

## N E N I 23

Administratori mund te shkarkohet:

- Me kerkesen e tij apo me mbarimin e afatit te emerimit

- Kur ortaku themelues verteton qe ai eshte per gjegjes per mosarritjen e rezultateve te kerkuara ne kuadrin e plan bisneseve te shoqerise apo kur konstatohen shkelje te rregullave te brendeshme te shoqerise.

- Ne rastet e tjera te parashikuara me ligj.

## N E N I 24

Forma e bilanceve dhe librave te llogarise qe do te mbaje shoqeria percaktohen nga legjislacioni I shtetit Shqiptar por per nevoja te shoqerise munt te perpilohen dokumentacion plotesues sipas gjykimit te administratorit te shoqerise

## VII. NDARJA E FITIMIT

### N E N I 25

Per perballimit te detyrimeve, pagave, taksave, tatimeve dhe shpenzimeve te tjera nga fitimi i shoqerise, asaj i mbeten ne dispozicion fitimi neto, i cili ndahet sipas kontributit dhe ashtu sic parashikohet ne kontraten e themelimit.

### N E N I 26

Ne qoftese ne bilancin 4 mujor shoqeria nuk del me fitim, por me humbje, humbjet do te mbulohen ne perputhje me kuoten e investuar me rastin e krijimit te shoqerise. ne se mbas kryerjes se veprimit te parashikuar nga paragrafi i mesiperme nuk do te mbulojne kete humbje atehere ndaj shoqerise hapet procedura e likuidimit (falimentimit), ne rast se vazhdimi i metejshem i aktivitetit te saj ekonomiko-financiar eshte i pamundur.

## VIII. ORGANIZIMI I BRENDESHEM I SHOQERISE

### N E N I 27

Shoqeria kryen veprimtarine e saj me ane te njesive organizative qe cakton ajo vete (asambleja e shoqerise). Keto njesi organizative quhen sektore. Sektoret nuk kane status te personit juridik dhe as autorizime ne qarkullim juridik me personat e trete.

Sektoret drejtohen nga admnistratori i shoqerise, i cili mund te emeroje te gjitha organikat administrative te shoqerise. E gjithe struktura administrative, per detyrat funksionale qe kryen, jep llogari para administratorit dhe drejtorit te shoqerise.

## IX. MARREEDHENIET E PUNES

### N E N I 28

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me kontraten per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut.

### N E N I 29

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

- Kushtet dhe menyra e krijimit te marredhenieve te punes.
- fillimi i punes se punonjesit (koha) dhe caktimi i tij ne vendin e punes.
- Caktimi i kohes se punes, puna gjate nates, puna jashte kohes noramle te punes, puna ne ditet e pushimit favor dhe festave zyrtare e fetare.
- Mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, sigurimet shoqerore, paga.
- Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe perjegjesia e punonjesit per zbatimin e detyrave te tij.
- Menyren e pushimit te marredhenieve te punes.

### N E N I 30

Punonjesit per punen e tyre marrin pagen, e cila eshte ne vartesi te rezultateve te arritura ne pune, ne perputhje me kontraten e punes. Ne kontraten e punes caktohen: paga e punonjesit, shperblimi mbi page si dhe shperblime te tjera.

## X. PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

### N E N I 31

Administratori, drejtori, perjegjesat e sektoreve dhe punonjesit e tjere te shoqerise bartin dhe perjegjesite materiale per marrjen e vendimeve jo ligjore, te cilat demtojne materialishi shoqerine, ortaket, si themelues te shoqerise, ne vartesi nga ndikimi i tyre per marrjen dhe zbatimin e vendimeve te tillë.

Te gjithe personat e mesiperme te parashikuar ne paragrin e pare te ketij nenii, ne rast se nga veprimet e tyre eshte shkaktuar dem qe formon veper penale, do te pergjigjen sipas legjislacionit penal shqiptar dhe do te gjykohen nga gjykata shqiptare. Per demin civil do te

pergjigjen sipas legjislacionit civil shqiptar

## XI. KOHEZGJATJA E SHOQERISE

N E N I 32

Afati i veprimtarise se shoqerise "COFFEE CLUB" sh.p.k. parashikohet mbi 10 vjet.  
Ajo mund te zgjatet me vendim te asamblese se shoqerise.

Shoqeria merr fund ne rastet e percaktuara nga legjislacioni shqiptar, ne baze te vendimit te asamblese se shoqerise dhe kur hapet procedura e likuidimit, perkatesisht e falimentimit.

N E N I 33

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e e saj ne Gjykatene e rrrethit Tirane, ku ndodhet dhe regjistri tregtar dhe paisjen e saj konform ligjit me dokumentat fiskale te nevojshme.

N E N I 34

Ky status radaktohet ne gjuhen Shqiptare ne 5 kopje origjinale dhe nenshkruehet nga ortaku themelues pasi ju perkthehet prej perkthyeses prane zyres notoriale

ORTAKU THEMELUES  
ARNOLDI DANTE

ARNOLDI DANTE

Dante Arnoldi

REPUBLICA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE DURRES  
Noter Ali Turku  
Nr....Rep 147  
Nr....Kol 43

✓

## VERTE TIM

Sot me date 31.01.2003 u paraqit para meje Noter Ali Turku **Dante Arnoldi**, te cilit pasi iu verifikua identiteti dhe zotesia e plete juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi I tij dhe firmosi para meje Noterit statusin e themelimit te shoqerise "COFFEE CLUB" sh.p.k redaktuar jashtë kesaj zyre pasi iu perktheje prej perkthyeses Levilo Ali, gje qe e vertetoj irregullisht.

